

Ky departament trajton rreth 200 pacientë në ditë dhe është i hapur 24 orë në ditë, 365 ditë në vit. Ai siguron trajtime për të shpëtuar jetën dhe kujdes mjekësor urgjent për ata që kanë sëmundje ose plagë të rënda.

Fëmijët

■ Për fëmijët është një zonë e veçantë pritje, e hapur nga 10:00 – 22:00, 7 ditë në javë. Prindërit/kujdestarët duhet t'i mbikqyrin fëmijët e tyre gjatë gjithë kohës. Ne nuk mund të kujdesemi për fëmijët e të rriturve që nuk ndjehen mirë. Ju lutemi merrni masa për t'i çuar ata në shtëpi sa më shpejt që të jetë e mundur.

Mjediset për ushqimin me gji

■ Infermierja e turnit mund t'ju shpjegojë mjediset për ushqimin me gji.

A është ky spitali juaj vendor?

■ Nëse ky nuk është spitali juaj vendor, mund të ekzistojë një kufi në lidhje me kujdesin e mëvonshëm që mund t'ju ofrojmë.

Miqtë dhe kujdestarët

■ Ne jemi të gëzuar që miqtë dhe kujdestarët qëndrojnë me pacientin, por ndonjëherë mund të na duhet t'u kërkojmë të largohen nga dhoma.

Pije freskuese

■ Në zonën e pritjes ka makina të pijeve dhe personeli mund t'ju drejtojë tek restoranti i spitalit nëse jeni të uritur. Pyesni infermierën e turnit përpara se të hani ose të pini dhe mos konsumoni alkool. Pirja e duhanit nuk lejohet në asnjë mjedis në spital.

Banjat

■ Nëse keni nevojë për udhëzime për në banja, pyesni infermierën e turnit.

Shërbimet tona speciale

- Disa pacientë do të vizitohen nga një infermiere praktikuese e urgjencës. Këto janë infermiere të trainuara në mënyrë të veçantë, të cilat janë të kualifikuara për të trajtuar sëmundje/plagë të lehta. Kështu që mund të mos keni nevojë për t'u vizituar nga një doktor & mund të shkoni më shpejt në shtëpi
- Ne marrim referime GP për t'u shqyrtuar nga doktorët e specializuar dhe zhvillojmë vizita të mëpasshme për pacientët e A&E dhe një vizitë të përditshme të pastrimit të plagëve. Pacientët e referuar nga GP të tyre do të vizitohen nga një doktor i specializuar sa më shpejt që një prej tyre të jetë në dispozicion.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutemi flisni me infermierën e turnit, e cila mund t'ju referojë tek infermierja e caktuar.

Royal Free Hampstead 
NHS Trust

DEPARTAMENTI I AKSIDENTEVE & URGJENCAVE (A&E)

Linja e drejtpërdrejtë: 020 7830 2110

Kjo broshurë shpejgon sesi administrohet departamenti dhe sesi caktohet rendi i përparësisë së pacientëve.

Emri:

Përparësia juaj është:

Koha mesatare e pritjes:

Ne e kuptojmë se mund të jeni të shqetësuar në lidhje me gjendjen tuaj ose gjendjen e personit që jeni duke shoqëruar. Ne përpiqemi të mos kapërcejmë kohën mesatare të pritjes, por kjo mund të jetë e pashmangshme kur jemi shumë të zënë ose nëse ka urgjenca të reja.

Pas mbërritjes, ju i dhatë hollësitë tuaja personelit të pritjes. Një infermiere e specializuar (infermiere e turnit) më pas ju vlerësoi, duke përdorur sistemin standart NHS për përcaktimin e prioritetit të pacientëve.

Infermierja e turnit mund të kërkojë të bëni rreze x dhe mund t'ju japë qetësues për dhimbje. Pacientët më pas do të vizitohen sipas nevojës së tyre, jo sipas kohës së mbërritjes.

PERPAREsia 1 (E KUQE)

Pacientë që u kërcënohet jeta, të cilët duhet të vizitohen ose mund të vdesin. Ne synojnë t'i vizitojmë këta pacientë menjëherë.

PERPAREsia 2

(PORTOKALL) Pacientë që janë shumë të sëmurë, por jeta e të cilëve nuk është në rrezik të menjëhershëm (p.sh. ata me djegje të rënda, dhembje kraharori ose vështirësi të mëdha në frymëmarrje).

PERPAREsia 3 (E VERDHE)

Pacientë me probleme të rënda, por që janë qetësuar dhe mund të presin të sigurtë (p.sh. ata me dhembje në bark, gjymtyrë me fraktura ose astma të rënda).

PERPAREsia 4 (JESHILE)

Pacientë që nuk janë në rrezik të menjëhershëm prej sëmundjeve ose plagëve të tyre (p.sh. ata me fraktura të vogla, prerje ose ndrydhje, dhembje të muskujve).

PERPAREsia 5 (BLE)

Pacientë me sëmundje ose plagë prej një kohe të gjatë.

Brenda të gjithë kategorive, **rastet më të rënda** vizitohen të parat.

Ka të ngjarë se do t'u duhet të prisni derisa **rezultatet e testeve** të vihen në dispozicion përpara sesa të vendoset për trajtimin tuaj.

Ne kemi disa klinika në A&E.

Pacientët që vizitohen në këto nuk ndikojnë mbi përparësinë apo kohën e pritjes të të tjerëve.

Pacientët që mbërrijnë me ambulanca kanë të njëjtën përparësi si ata që vijnë në departament në mënyra të tjera.

Nëse ndjeni se jeni ërkeqësuar, ju lutemi flisni me infermierën e turnit.

Ne synojmë t'ju vizitojmë, trajtojmë dhe pastaj t'ju pranojmë, t'ju lejojmë të largoheni ose t'ju refërojmë, sa më shpejt që të jetë e mundur, duke siguruar në të njëjtën kohë një shërbim profesional për pacientët e tjerë.

Ju lutemi vini re:

- Ne nuk tolerojmë abuzimin me fjalë dhe fizik, si dhe dhunën ndaj personelit.
- Ne nuk mund të organizojmë vizita në shtëpi për gjendje jo-urgjente – ju duhet t'a beni këtë nëpërmjet GP tuaj.
- Trusti mund mund të mbajë përgjegjësi për sendet personale me vlerë.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj.

© A&E Department /
Programi i Informacionit të Pacientit
2003
www.royalfree.nhs.uk